



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23 Shkurt 2021

Nr: 99

VENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË DURRËS, ME  
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË SOCIALISTE TË  
SHQIPËRISË, Z. FATMIR NASIP MERKURI**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ

Me shkresën nr. 1497 prot., datë 04.02.2021, këshilli i bashkisë Durrës, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës nga këshilltari z. Arben Bashkim Isaku, propozuar nga subjekti partia Socialiste e Shqipërisë.

Referuar nenit 164, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumëmemërore e partisë Socialiste e Shqipërisë, është kandidati me numër rendor 49, z. Fatmir Nasip Merkuri.

Me shkresën nr. 969/1 prot., datë 09.02.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në këshillin e bashkisë Durrës, z. Fatmir Nasip Merkuri, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.



Data: 23 Shkurt 2021

Nr: 99

Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Durrës, me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste, z. Fatmir Nasip Merkuri

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit partia Socialiste e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 009 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, të kandidatit për anëtar, z. Fatmir Nasip Merkuri, në këshillin e bashkisë Durrës, rezulton se, në rubrikën III, “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, PIKA 8, “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”, ka deklaruar se ka jetuar në Lamia, Greqi, për arsye emigracioni, për periudhën 1997 deri më 2006 (periudha të shkëputura).

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, me shkresën nr. 1245 prot., datë 16.02.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 1244 prot., datë 16.02.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar, z. Fatmir Nasip Merkuri, në këshillin e bashkisë Durrës, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nu i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar në këshillin e bashkisë Durrës, z. Fatmir Nasip Merkuri.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 1684/1 prot., datë 19.02.2021, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar z. Fatmir Nasip Merkuri, në këshillin e bashkisë Durrës, e cili rezulton se nuk ka shënime në sistem.

Referuar pika 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatoj se, të dhënat e kandidati për anëtar z. Fatmir Nasip Merkuri, në këshillin e bashkisë Durrës, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.



## **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

## **V E N D O S:**

1. Z. Fatmir Nasip Merkuri, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Durrës, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Durrës, me kandidatin nga lista shumemërore e partisë Socialiste e Shqipërisë, z. Fatmir Nasip Merkuri.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

